



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:017884

Datë: 20.03.2023

Numri i dokumentit: 04097776

Pml.nr.26/2023

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit G.S. nga fshati S., komuna e L., me vendbanim në M., Republika e S., për shkak të veprës penale krimet e luftës kundër popullatës civile, nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit dhe kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë ushtruar nga Prokurori i Shtetit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.11/2020 datë 05.10.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.28/2022 datë 27.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16 shkurt 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara, kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë, ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit G.S. dhe Prokurorit të Shtetit, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.11/2020 datë 05.10.2021 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.28/2022 datë 27.09.2022.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.11/2020 e datës 05.10.2021, ka shpallur fajtor të dënuarin G.S., për shkak të veprës penale krimet e luftës kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, dhe konform nenit 3, 4, 5, 6, 7, 8, 11, 12, 13, 22, 25, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 38, 41, 50 dhe nenit 142 të LP të RSFJ dhe Rregullores së UNMIK-ut mbi Ligjin në fuqi,

nr.199/24, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) vite e në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20 korrik 2019 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.

Po ashtu gjykata e ka obliguar të dënuarin që të paguajë shumën prej 300 (treqind) €, në emër të shpenzimeve procedurale dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil- juridik.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.28/2022 e datës 27.09.2022, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e mbrojtësit e të dënuarit G.S. dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit, të dënuarin G.S. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite e në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.07.2019 e tutje. Pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbet e pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar:

- mbrojtësi i të dënuarit G.Sh., avokati Lubomir Pantoviq nga Mitrovica, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet të anulohen dhe i dënuari të lirohet nga akuza ose të ndryshohen dhe çështjen ta kthejë në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje,

- ndërsa Prokurori i Shtetit ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që konform nenit 438 par.2 të KPP-së, të konstatohet se aktgjykimi i shkallës së dytë përmban shkelje të ligjit penal apo si pasojë e dyshimit të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të urdhërojë shqyrtim të ri gjyqësor.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësat KMLP.II.nr.21/2023 e datës 27.01.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësi i të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e kësaj çështjeje penale në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të Kodit Procedurës Penale (KPP), dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, janë të pabazuara.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit G.Sh., avokati Lubomir Pantoviq, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni

384 par.2 nënpar.2.1 lidhur me nenin 361 par.2 të KPP-së, e të cilat shkelje qëndrojnë në faktin se ligji është zbatuar gabimisht dhe në dëm të pandehurit. Për më tepër, aktgjykimet nuk përmbajnë arsye për faktet vendimmarrëse, ndërsa arsyet e dhëna janë të paqarta çka i bënë aktgjykimet të pakuptueshme dhe të papranueshme.

Më tutje në kërkesë, mbrojtësi vë në pikëpyetje vlerësimin e provave të administruara dhe besueshmërinë e këtyre provave mbi bazën e të cilave është konstatuar fajësia e të dënuarit duke konsideruar se si Prokuroria Speciale ashtu edhe gjykatat në mënyrë tendencioze kanë injoruar deklaratat e dëshmitarëve dhe provat të cilat shfaqësojnë të dënuarin dhe për pasojë gjykatat kanë vendosur duke për bërë zgjedhjen selektive të tyre vetëm me qëllim të justifikohet vendimi dënues. Pjesa më e madhe e arsyesimit të aktgjykimit konsiston në citimin e këtyre deklaratave të cilat janë vlerësuar vetëm disa pjesë të tyre duke mos dhënë arsyetim se pse i ka besuar deklaratave të cilat janë diametrisht të kundërta dhe të cilat ishin marrë para se i dënuari të arrestohej. Për më tepër Prokuroria Speciale disponon me të gjitha shkresat e hetimit të kryer nga vitit 1999 të cilin e kanë bërë hetuesit e Hagës për ish Jugosllavi (ICTY), UNMIK dhe EULEX, por asnjë nga këto dëshmi nuk janë paraqitur në gjykatë sepse nuk i kanë konvencuar dhe sepse në to nuk akuzohet i dënuari për asnjë veprim për të cilin është dënuar. Ndërsa tani të njëjtët dëshmitar deklarojnë ndryshe dhe e akuzojnë për pjesëmarrje në krime.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal, mbrojtja konsideron se meqenëse aktgjykimet janë marrë me shkelje të dispozitave të procedurës penale atëherë është evidente se edhe ligji penal është shkelur në dëm të dënuarit.

Gjykata Supreme, vlerësoi pretendimet nga kërkesa e mbrojtësit të dënuarit G.S., dhe gjeti se arsyetimi i aktgjyqimeve të kundërshtuara është i qartë dhe përmban të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje penalo-juridike dhe se i njëjti është përpiluar konform dispozitave 370 par.6 të KPP-së. Në arsyetim janë paraqitur arsye të mjaftueshme ligjore për të gjitha pikat si ato faktike ashtu edhe juridike mbi bazën e të cilave është marrë vendimi meritore e të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye lidhur me provat kontradiktore, duke i paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesish i merr të provuara ose si të paprovuara, pra duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore dhe duke i vlerësuar të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe për këtë ka paraqitur konstatimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Ndërsa gjykata e shkallës së dytë në aktgjykim ka dhënë arsyetim lidhur me të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar të njëjtat. Të gjitha këto i bëjnë aktgjykimet të qëndrueshme juridikisht, ndërsa pretendimet se janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të pabaza sa i përket të dënuarit G.S.

Edhe kjo gjykatë, konsideron se drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur ka gjetur se hetimet në këtë çështje penale kanë filluar menjëherë pas përfundimit të luftës me 1999, nga ana e institucioneve ndërkombëtare që kanë qenë të pranishme dhe kompetente për këtë. Të gjitha këtë shkresa të cilat kanë dal si rezultat i këtyre hetimeve, janë transferuar në PSRK dhe në vitin 2019 i dënuari G.S., është arrestuar, e në bazë të pohimeve dhe dëshmimeve nga të cilat është konstatuar se ka dyshim të bazuar se i njëjti është i përfshirë në krimet ndodhura në fshatin

S. dhe T. të L. Pra, nuk qëndron fakti se nga dëshmitë të cilat janë mbledhur në hetimet e zhvilluara nga hetuesit e Hagës për ish Jugosllavi (ICTY), UNMIK dhe EULEX, asnjëherë nuk është pretenduar nga askush, se i dënuari ka qenë pjesëmarrës në këto masakra. Këtë e dëshmojnë dëshmitarët okular të cilët që nga fillimi i hetimeve e kanë identifikuar si njërin prej atyre që kanë marrë pjesë në dëbimin, vrasjen, ushtrimin e dhunës ndaj popullatës civile shqiptare dhe vrasjen e anëtarëve të familjes G., vrasjen e J.K., B.G., M.P., R.K., A.I. dhe E.B. si dhe vrasjen e Z.G.

Sa i përket pretendimit se, si Prokuroria Speciale ashtu edhe gjykatat në mënyrë tendencioze kanë injoruar deklaratat e dëshmitarëve dhe provat të cilat shfajësojnë të dënuarin dhe për pasojë gjykatat kanë vendosur duke për bërë zgjedhjen selektive të tyre vetëm me qëllim të justifikohet vendimi dënues, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë në aktgjykim ka dhënë arsyetim lidhur me çdo pretendim për alibin e të dënuarit për ditët kur kanë ndodhur krimet si dhe arsyetim ligjor lidhur me secilën dëshmi të dëshmitarëve okular, e duke iu referuar edhe deklaratave të dhëna gjatë hetimeve të zhvilluara nga hetuesit e Hagës për krime lufte, e me të cilin konstatim është pajtuar edhe gjykata e shkallës së dytë, duke mos gjetur mospërputhje në deklaratat e dëshmitarëve si dhe duke u bazuar në faktin se nga vet dëshmitarët të cilët pretendojnë se ditën kritike, pra me 15 prill 1999, i dënuari nuk ka qenë fare në fshatin S., por fillimisht ka qenë Stacionin Policor në L., ku ka shkuar çdo ditë nga ora 07:00 deri më ora 15:30 dhe është kthyer pasi që ka përfunduar masakra në këtë fshat (S.S.), ndërsa dëshmitarja S.P., deklaroi se ditën kritike rreth orës 13:00, ajo e ka parë të dënuarin duke ardhur nga puna nga L., ku para shitores ku ajo ka punuar në fshatin D. i ka treguar se gjendja e sigurisë në fshatin S. është e keqe, duke theksuar se nuk i kujtohet data kur ka ndodh kjo, por atë ditë ka qenë varrimi i kumbarës së të dënuarit (Z.G.). Ndërsa vet i dënuari në mbrojtjen e tij thekson se me datën 15 prill 1999, datë kur pretendon se e ka takuar dëshmitaren edhe pse vdekja e të ndjerit G. ka ndodhur me datën 14 prill 1999, ndërsa është varrosur me datën 16 prill 1999, e të cilin fakt e potencon edhe ai vet. Pra drejt ka konstatuar gjykata e shkallës së parë kur nuk i ka besuar deklaratave të dëshmitarëve pasi që këto deklarata bien ndesh me vet pretendimet mbrojtëse të të dënuarit, se ai me 15 prill 1999, ka qenë në punë në L. Pra, dita kur është organizuar varrimi i të ndjerit G. dhe kur dëshmitarja P. e ka takuar të dënuarin është data 16 prill 1999, pasi që këtë ditë edhe vet i dënuari pretendon se është varrosur i ndjeri G. Po ashtu, nga deklarata e dëshmitarit S.S., vërtetohet se me datën 15 prill 1999, i dënuari së bashku edhe me policët R. dhe G., ka qenë edhe T. (i dënuari), dhe atë që nga mëngjesi deri në mesditë, në shkollën e fshatit S. duke e pritur shefin e ushtrisë së bashku me komisionin e formuar nga banorët shqiptar, e jo siç ka pretenduar se ka qenë gjithë ditën në Stacionin policor në L.

Edhe pse i dënuari është shpallur fajtor edhe për veprimet e kryera me datën 16 prill 1999, të gjithë dëshmitarët e propozuar nga mbrojtja, S.S., B.G. dhe D.T., kanë deklaruar se me datën 16 prill 1999 ka qenë varrimi i kumbarës së tij (të vrarë nga sulmet e NATO-së) dhe se ceremonia e varrimit ka filluar pas orës 13:00 apo 14:00, e pastaj ka vazhduar me drekën e cila i është shtruar pjesëmarrësve, por vet i dënuari ka theksuar se ai ka shkuar në ceremoni të varrimit të kumbarës që nga mëngjesi pra nga ora 8:00 e mëngjesit, çka bie në kundërshtim me deklaratimet e dëshmitarëve të dëgjuar.

Pra, nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtjes se si Prokuroria Speciale ashtu edhe gjykata në mënyrë tendencioze kanë injoruar deklaratat e dëshmitarëve të cilat e shfaqësojnë të dënuarin G.S., sepse gjykatat kanë dhënë arsyetime logjike dhe ligjore lidhur me rrjedhën e ngjarjeve, duke elaboruar pjesëmarrjen e të dënuarit në masakrën e fshatit S. të L. dhe fshatit T., e bazuar edhe në faktet të cilat janë vërtetuar gjatë procedurës penale.

Nga të gjitha këto prova të administruara, drejt është vërtetuar se tani i dënuari G.S., ka qenë së bashku edhe me familjen e tij, banor i fshatit S. të L., deri në përfundimin e luftës-konfliktit të armatosur në Kosovë dhe hyrjen e forcave të NATO-së në Kosovë, ku i njëjti është larguar me gjithë familjen e tij në S. Për më tepër, i dënuari dhe familja G. kanë qenë fqinj edhe me shtëpi edhe me prona dhe janë njohur dhe kanë komunikuar si dhe kanë pas marrëdhënie fqinjësore, fakt ky të cilin nuk e ka mohuar as vet i dënuari, gjatë procedurës penale. I dënuari ka qenë djali i T.S. dhe nga banorët e fshatit dhe fqinjët e tij ka qenë i njohur me nofkën “T.”. Në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë, ka qenë pjesëtar i armatosur dhe në uniformë, i forcave policore rezerve serbe, që nga tetori i vitit 1998, e deri në përfundim të luftës dhe ka shërbyer në Stacionin Policor në L. Këtë fakt e vërteton edhe vet i dënuari, por e mohon se ka qenë pjesëmarrës në krimet e kryera ndaj familjes G. dhe personave tjerë të vrarë në këto ngjarje.

Po ashtu, është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve Z.G. dhe Gj.H. se i dënuari ishte në mesin e personave të uniformuar dhe të armatosur që i kanë vrarë 5 anëtarë meshkuj të familjes G. dhe se që të dyja ishin në ballkonin e katit të dytë në shtëpi të tyre në fshatin S., kur e kanë parë fqinjin e tyre G. apo “T.” siç e kanë identifikuar pothuajse të gjithë i cili ka qenë pa maskë dhe vetëm kur ka hy në oborr e ka vendosur maskën në fytyrë e të cilin identifikim e kanë bërë edhe përmes fotoalbumit, ndërsa nga raportet e autopsive për viktimat M.G., O.G., E.G. dhe B.H., është vërtetuar se të njëjtit kanë vdekur nga plagët me armë zjarri të shkaktuara nga një ose disa individ tjerë.

Sa i përket vrasjes së tani të ndjerëve J.K., B.G., M.P., R.K., A.I. dhe E.B., nga deklaratat e dëshmitarëve D.B., F.K., B.B., H.I., M.P., N.G., R.G. e A.B., vërtetohet se të ndjerët të gjithë civil, janë ndarë nga kolona e fshatarëve dhe janë rreshtuar pranë murit, duke u ekzekutuar pas pak, ndërsa në mesin e personave të cilët kanë qenë në uniforma të policisë dhe të cilët i kanë ndarë civilët e ndjerë nga kolona, ka qenë edhe i dënuari, të cilin e kanë identifikuar, pasi që e kanë njohur deklaratat këto të cilat i kanë dhënë dhe para hetuesve ndërkombëtar menjëherë pas luftës. Ndërsa, faktin se të ndjerët janë vrarë nga armë të ndryshme zjarri, e vërtetojnë edhe raportet e autopsive, të përpiluara nga ekspertët ndërkombëtar të cilët i kanë ekzaminuar mbetjet mortore, menjëherë pas përfundimit të luftës.

Edhe vrasja e të ndjerit F.B., është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve B.B. e F.G., dëshmitar okular, të cilët ditën kritike me datë 15 prill 1999, në orët e mbrëmjes rreth 18:00-19:00, dëshmojnë se në shtëpinë e F.B., është vrarë me armë zjarri nga katër persona, në mesin e të cilëve ishte edhe i dënuari G.S., të cilët kishin ardhur me veturën “Ll.S.”. Identifikimi i të dënuarit është bërë duke e përshkruar si djalin e T. dhe katundar i fshatit S., polic gjatë luftës, duke e përshkruar edhe pamjen e tij dhe moshën si dhe armën (AK-47) si dhe uniformën, si uniformë me lara dhe të paramilitarëve. Të gjitha këto deklaratat janë dhënë edhe para hetuesve

ndërkombëtar pas përfundimit të luftës. Ndërsa vrasjen me armë zjarri e konfirmojnë edhe raporti i autopsisë, ku nga ky raport rezulton se i ndjeri ka vdekur si pasojë e plagëve të marra nga të shtënat e disa armëve.

Sa i përket datës 16 prill 1999, drejtë kanë vërtetuar dy gjykatat, se i dënuari ka qenë një prej bashkë kryesve të vrasjes së të ndjerës Z.G. dhe plagosjes së të dëmtuarës A1, e duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve G.G. dhe A1, të cilët ishin dëshmitar okular, të cilët edhe në deklaratat e tyre të dhëna menjëherë pas luftës, dëshmojnë se ditën kritike e kanë njohur G. (djalin e T. apo T1. si i referohen të gjithë) duke përshkruar edhe fizikun e tij dhe faktin se i dënuari ka fol rrjedhshëm shqip, dhe se në këtë gjuhë ka komunikuar edhe ditën kritike. Ndërsa raporti i autopsisë për të ndjerën Z., vërteton se është vrarë nga armë zjarri, raporti i lëndimeve për të dëmtuarën A1, vërteton se e njëjta ka pësuar lëndime trupore nga armë zjarri.

Nga të gjitha këto drejtë kanë ardhur në përfundim të dy gjykatat se në veprimet e të njëjtit janë formuar elementet e veprës penale në bashkëkryerje krimet e luftës ndaj popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e sanksionuar edhe sipas nenit 3 të Konventave të Gjenevës dhe Protokollit II, pra i njëjti në bashkëveprime me pjesëtarët tjerë të forcave policore dhe paramilitare, me vetëdije e duke vepruar sipas planit dhe urdhrave të eprorëve të tij ka marrë pjesë direkt në sulmin dhe vrasjen e popullsisë civile të nacionalitetit shqiptarë konkretisht familjes G. dhe atë M.G., dy djemtë e tij E. dhe O.G. si dhe nipat A.G. dhe B.H., të cilët nuk kanë qenë pjesë aktive e konfliktit të armatosur, duke i larguar në mënyrë të dhunshme të anëtarët e kësaj familje, nën kërcënimin e armëve duke i trajtuar në mënyrë jo humane si dhe ka marrë pjesë në vrasjen e të ndjerëve, J.K., B.G., M.P., R.K., A.I., E.B., F.B., Z.G. dhe plagosjen e të dëmtuarës A1. Të gjithë këto veprime të kryera në bashkëkryerje, të të dënuarit përbëjnë elementet qenësore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, meqenëse me dispozitën e nenit 142 të LP të RSFJ, parashihet se “kush duke shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur ose okupacionit, urdhëron që kundër popullsisë civile të bëhen vrasje, tortura, sjellje çnjerëzore, eksperimente biologjike, shkaktimin e vuajtjeve të mëdha ose cenimin e integritetit trupor apo shëndetit ose transferime apo shpërngulje ose transferime apo ç ‘kombëtarizim me dhunë ose kthimin në ndonjë fe tjetër, shtrëngime për t’u marrë me prostitucion ose kryen dhunime seksuale, aplikimin e masave të frikësimit dhe të terrorit, marrjen e njerëzve peng, ndëshkime kolektive, dërgimin e kundërligjshëm në kampet e përqendrimit dhe kryen mbyllje të tjera të kundërligjshme, privimin e të drejtës në gjykimin e drejtë dhe të paanshëm; shtrëngime për të shërbyer në forcat e armatosur të fuqisë armike ose në shërbimin e saj informativ ose në administratën e saj, shtrëngime për të bërë punë të detyrueshme, lënien e popullsisë në uri; konfiskime të pasurisë, grabitje të pasurisë së popullsisë, asgjësimin e kundërligjshëm dhe arbitrar apo përvetësime në përpjesëtime të mëdha të pasurisë që nuk arsyetohet me nevoja ushtarake, merr kontribute dhe kryen rekuizime të paligjshme e në përpjesëtime të mëdha, kryen uljen e vlerës së parave të vendit ose emetimin e kundërligjshëm të parave, ose kush kryen ndonjë nga veprat e lartpërmendura do të dënohet të paktën me 5 vjet burg ose me dënim me vdekje”. Pra i dënuari ka marrë pjesë së bashku me pjesëtarët tjerë të forcave policore – ushtarake serbe, në kryerjen e të gjitha këtyre veprimeve të cekura më lart e duke shkelur njëkohësisht edhe Rregullat Ndërkombëtare të parapara me Konventat e Gjenevës dhe Protokollin e saj shtesë.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, të ushtruar nga Prokurori i Shtetit, i cili pretendon se në dobi të dënuarit është shkel ligji penal, kur është aprovuar kërkesa e mbrojtësit të dënuarit dhe kur ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që të dënuarin G.S. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor, e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së dytë nuk ka marrë për bazë praktikën e mëhershme të shqiptimit të dënimit për veprat e njëjta penale dhe në kundërshtim me interpretimin ligjor të të njëjtit në (neni 38 par.2 të LPJ) i cili parasheh se “Për veprat penale për të cilat është parashikuar dënimi me vdekje, gjykata mund të japë edhe dënimin me burgim deri në njëzet vjet.” Ndërsa me dispozitën e nenit 38 par.3 të LPJ është parapa se “Në qoftë se për veprën penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi prej pesëmbëdhjetë vjet, për formë të rënda të kësaj veprë mund të parashikohet edhe dënimi me burg deri në njëzet vjet”. Pra, gjykata ka mundur të shqiptoj edhe dënim me burg prej njëzetë vjet, meqenëse kemi të bëjmë me formë të rëndë të kryerjes së veprës penale dhe atë krim lufte e cila vepër është krim i rëndë. Po ashtu në kërkesë, potencohen edhe praktikën e gjykatave të rajonit, të cilat kanë qenë pjesë e ish Jugosllavisë dhe të cilat e aplikojnë ligjin e njëjtë (LPJ) kur vendosin lidhur me dënimet për vepra të njëjta penale, pra krime lufte.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjen se drejtë ka vepruar Gjykata e Apelit kur ka vendosur si në aktgjykim të saj, e duke u nisur nga fakti se në kohën kur është kryer vepra penale, ka qenë fuqi Ligji Penal i Jugosllavisë (LPJ) dhe me nenin 38 par.1 të këtij ligji ka qenë e parashikuar që “Dënimi me burg nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë ditë e as mi gjatë se pesëmbëdhjetë vjet.” Ndërsa në par.2 të njëjtit ligj parashihet se “Për veprat penale për të cilat është parashikuar dënimi me vdekje, gjykata mund të japë edhe dënimin me burgim deri në njëzet vjet.”

Me rregulloren e UNMIK-ut, nr.199/24 datë 12.12.1999, që ka hy në fuqi me 10 qershor 1999, është shfuqizuar dënime me vdekje dhe nuk është përcaktuar dënimi me burg afatgjatë si zëvendësim. Pra, si alternativ e dënimit me vdekje ka mbetur dënimi me burg deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Gjykata Supreme, gjen se në rastin konkret nuk mund të zbatohet neni 38 par.3 i LPJ, i cili nen parasheh se: “Në qoftë se për veprën penale të kryer me dashje është parashikuar dënimi prej pesëmbëdhjetë vjet, për formë të rënda të kësaj veprë mund të parashikohet edhe dënimi me burg deri në njëzet vjet”, meqenëse për të shqiptuar një dënim të tillë duhet të plotësohen disa kushte dhe atë: që të bëhet fjalë për format e rënda të veprave penale të kryera me dashje dhe të për ato vepra të jetë i paraparë dënimi deri në pesëmbëdhjetë vjet. Nga kjo rrjedhë se dënimi me burg prej njëzet vjet nuk mund të shqiptohet për një vepër penale bazë por vetëm për formën e rëndë të një veprë bazë. Forma e rëndë duhet të jetë e parashikuar me ligj dhe nuk mund të ngatërrohet me rrethana rënduese të kryerjes së një veprë penale. Pra, qëndron fakti se krimet e luftës, vetvetiu janë vepra të rënda si nocion, por në rastin konkret neni 142 i LPJ, parasheh vetëm një vepër (veprën bazë) dhe atë krime lufte duke mos parapa formë të rënda të kryerjes. Duhet të theksohet se ligjdhënësi i atëhershëm, duke konsideruar se është vepër e rëndë, edhe e ka parapa

dënimin kapital për kryerjen e kësaj veprë penale, andaj edhe nuk ka parapa forma më të rënda të saj, mirëpo kjo nuk mund të interpretohet në dëm të dënuarit. Kjo edhe për faktin se ligjet e mëvonshme nuk kanë parapa këtë dënim dhe e vetmja mënyrë e zbatimit të nenit 38 të LPJ, është ajo, që meqë nuk kemi me dënim me vdekje, si alternativ mund të jetë vetëm dënimi deri me pesëmbëdhjetë vjet.

Po ashtu qëndron fakti se ka aktgjykime të cilat janë të ndryshme në raport me shqiptimin e dënimit dhe interpretimin e nenit 38 të LPJ, nga ana e gjykatave në rajon, por kjo nuk mund të merret si praktik gjyqësore e cila mund të zbatohet në gjykata tona, meqenëse Gjykata Supreme e Kosovës, është ajo e cila jep mendimin përfundimtar në një çështje penale.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart e në mbështetje të dispozitës së nënti 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pml.nr.26/2023, më 16 shkurt 2023

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi